

**KONFERENCA PËR ANËTARËSIMIN NË  
BASHKIMIN EVROPIAN  
- SHQIPËRIA -**

**Bruksel më 11 tetor 2024  
(ORIGJINALI Ang.)  
AD 18/24  
KONF-ALB 3**

**DOKUMENT PËR ANËTARËSIMIN**

---

Lënda: QËNDRIMI I PËRBASHKËT I BASHKIMIT EVROPIAN  
- Grupkapitulli i I - rë: “Themelorët”

---

## QËNDRIMI I PËRBASHKËT I BASHKIMIT EVROPIAN

Ky qëndrim i Bashkimit Evropian bazohet në qëndrimin e përgjithshëm në kuadër të Konferencës së Anëtarësimit me Shqipërisë (AD 5/22 CONF-ALB 2) dhe i nënshtrohet parimeve të negocimit të mbështetura gjatë saj, dhe në veçanti:

- çdo pikëpamje e shprehur nga Shqipëria ose BE-ja për një kapitull të veçantë të negociatave nuk paragjykon në asnjë mënyrë qëndrimin që mund të mbahet për kapituj të tjerë;
- marrëveshjet e arritura gjatë negociatave për kapituj të veçantë, qoftë edhe të pjeshme, mund të mos konsiderohen si përfundimtare deri në arritjen e marrëveshjeve të përgjithshme për të gjithë kapitujt;

si dhe sa iu përket kërkesave të përcaktuara në pikat 3, 5, 10, 14, 16, 31, 33, 36, 38, 39, 46, 47 dhe 48 të Kuadrit Negociues.

BE-ja inkurajon Shqipërinë të vijojë procesin e përafrimit me *acquis-në* e BE-së dhe të vijojë me forcimin dhe zbatimin në mënyrë efektive të këtij legjislacioni, si dhe të hartojë përpara anëtarësimit politika dhe instrumente sa më të përputhshme me atë të BE-së të jetë e mundur.

BE-ja vlerëson se në qëndrimin e saj AD 19/24 CONF-ALB 4, Shqipëria pranon *acquis-në* e BE-së në kuadër të Grupimit të I-rë sikurse në fuqi më 2 tetor 2024 dhe se do të jetë gati ta zbatojë atë që prej datës së anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

## 1. Funkcionimi i institucioneve demokratike

Bashkimi Evropian (BE) vlerëson se Shqipëria ka përcaktuar rendin e saj kushtetues dhe themelet e **shtetit demokratik** dhe po vijon konsolidimin e institucioneve të veta demokratike, dhe se kuadri ligjor dhe institucional mundësojnë një proces zgjedhor demokratik. BE-ja fton Shqipërinë të adresojë disa paqartësi ligjore dhe mospërputhje të theksuara nga OSBE/ODIHR-i, si dhe rekomandimet e tjera të përbashkëta të OSBE/ODIHR-it dhe Komisionit të Venecias. Legjislacioni për mediat në fushatë zgjedhore duhet të fuqizohet më tej, në veçanti në lidhje me keqinformimin dhe platformat në internet. Sa i përket financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore, BE-ja vlerëson pozitivisht se rishikimi i kuadrit ligjor ka siguruar më shumë transparencë, por zbatimimi i këtij kuadri duhet të konsolidohet.

BE-ja vlerëson se roli i **kuvendit** të Shqipërisë është konsoliduar me kalimin e kohës. BE-ja inkurajon përpjekje të mëtejshme për të rritur transparencën dhe llogaridhënien, integritetin dhe efektivitetin, duke përfshirë ndërveprimet midis Parlamentit dhe OJF-ve/OSHC-ve si dhe në lidhje me publikimet e tij. BE-ja risjell në vëmendje se Parlamenti funksional që ushtron në mënyrë efektive rolin e tij mbikëqyrës dhe ligjvënës, është shtyllë themelore e procesit të anëtarësimit. BE-ja risjell në vëmendje nevojën që Parlamenti të jetë i aftë të përdorë të gjithë mekanizmat, përfshirë komisionet hetimore, për të mbikëqyruar në mënyrë efektive punën e Qeverisë. BE-ja thekson se dialogu politik konstruktiv dhe përfshirës në parlament është thelbësor dhe në interes të qytetarëve shqiptarë. BE-ja vlerëson më tej se megjithëse veprimtaria parlamentare vijon të ndikohet negativisht nga polarizimi politik, Parlamenti ka pasur sukses në miratimin me shumicë votash ndërpartiake të ndryshimeve ligjore për forcimin e rolit të tij në procesin e integritimit në BE.

BE-ja thekson se në përgjithësi, kuadri ligjor, rregullator dhe institucional për **Organizatat e Shoqërisë Civile** është në fuqi, por ka nevojë për përmirësime të mëtejshme për të mundësuar zbatimin e plotë të kuadrit ligjor, veçanërisht lidhur me procedurat e regjistrimit. BE-ja vlerëson se proceset e konsultimit duhet të përmirësohen duke u bërë gjithëpërfshirëse, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë, dhe se ka nevojë për përpjekje dhe burime të mëtejshme për të siguruar mjedis të qëndrueshëm dhe mundësues për shoqërinë civile.

## 2. Reforma e administratës publike

BE-ja vlerëson se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në **kuadrin strategjik të reformës në administratën publike**. BE-ja thekson nevojën që Shqipëria të hartojë dhe miratojë brenda afateve të përshtatshme strategjitë e reja për Reformën e Administratës Publike (RAP) dhe Menaxhimin e Financave Publike (MFP). Duhet të garantohet përputhshmëria e përgjithshme e Strategjisë për RAP-in me dokumentet e tjera të planifikimit strategjik dhe të politikave, si dhe qëndrueshmëria financiare e reformave që lidhen me RAP-in. BE-ja thekson se sistemi i bashkërendimit të politikave vijon të jetë kompleks dhe duhet të thjeshtohet, dhe se bashkërendimi dhe drejtimi politik për zbatimin dhe monitorimin e reformave duhet të fuqizohen.

BE-ja thekson se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur lidhur me zhvillimin **dhe koorinimin e politikave**. Legjislacioni në fushën e zhvillimit të politikave është pjesërisht i përafuar me standardet e BE-së. BE-ja thekson se Shqipëria duhet të fuqizojë kuadrin rregullator me qëllim përmirësimin e planifikimit afat-mesëm të politikave, të shtrijë përdorimin e vlerësimit të ndikimit rregullator në legjislacionin dytësor dhe të përforcojë rolin e mbikëqyrjes parlamentare ndaj qeverisë.

BE-ja vlerëson se legjislacioni shqiptar për **shërbimin civil** është gjerësisht i përafuar me parimet themelore të rekrutimit, ngritjes në detyrë dhe lirimimit të bazuar në meritë dhe transparencë. Megjithatë, dispozitat për rekrutimin dhe ngritjen në detyrë të bazuara në meritë duhet të zbatohen në mënyrë të qëndrueshme në praktikë në të gjitha nivelet. BE-ja vlerëson se Shqipëria ka nevojë të reformojë sistemin e shpërblimit me qëllim që të jetë më transparent dhe i drejtë, me kritere të qarta për shtesat dhe rritjen e pagave. BE-ja thekson se Shqipëria duhet gjithashtu të harmonizojë dhe zbatojë sistemin e klasifikimit të pozicioneve të punës në të gjitha institucionet.

BE-ja vlerëson se kuadri ligjor aktual për **organizimin e organeve të administratës qendrore** nuk përcakton tipologji dhe kritere të qarta për krijimin e organeve vartëse, dhe as nuk sqaron linjat e llogaridhënies ndërmjet organeve eprore dhe atyre vartëse. BE-ja fton Shqipërinë të trajtojë këtë çështje, si dhe të përforcojë mbikëqyrjen e institucioneve në varësi nga ministritë përkatëse. BE-ja thekson më tej se Shqipëria duhet të përmirësojë transparencën e institucioneve publike, përfshirë edhe përmes fuqizimit të qasjes së qytetarëve në informacionin publik.

BE-ja sjell në vëmendje se digjitalizimi është rruga drejt një administrate publike më të mirë që ofron shërbime elektronike më efikase, më të efektshme dhe me cilësi të lartë, me kosto më të ulëta administrative dhe me më pak pengesa për qytetarët dhe bizneset. BE-ja vlerëson se Shqipëria ka ndërmarrë një proces ambicioz të **digjitalizimit të shërbimeve publike** që aktualisht përfshin rreth 95% të të gjitha shërbimeve publike. BE-ja fton Shqipërinë të garantojë trajtim të barabartë dhe qasje në shërbimet administrative për të gjithë qytetarët dhe bizneset. BE-ja inkurajon më tej Shqipërinë të vijojë përpjekjet për thjeshtimin e proceseve dhe shërbimeve administrative dhe të përforcojë sigurinë kibernetike. BE-ja vlerëson planet e Shqipërisë për rishikimin e legjislacionit për interoperabilitetin. Në këtë kuadër, BE-ja risjell në vëmendje gjithashtu edhe nevojën për forcimin e interoperabilitetit ndërkufitar përmes kuadrit kombëtar të interoperabilitetit, i cili të jetë në përputhje të plotë me Kuadrin Evropian të Interoperabilitetit si bazë për shërbime publike digjitale, me interoperabilitet dhe të cilat kanë në qendër njeriun. BE-ja inkurajon Shqipërinë të monitorojë zhvillimet në *acquis-në* e BE-së në fushën digjitale, në veçanti legjislacionin për shërbimet elektronike të identifikimit dhe besimit (Rregullorja eIDAS), që po rishikohet aktualisht, me qëllim ngritjen e portofolit kombëtar të identitetit digjital.

BE-ja vlerëson se në Shqipëri ekziston një kuadër të i mirë-përcaktuar për **menaxhimin e financave publike**. BE-ja thekson rëndësinë që Shqipëria të përmirësojë mëtej kuadrin buxhetor afatmesëm dhe të rrisë kapacitetet institucionale për monitorimin e risqeve fiskale, si dhe të përmirësojë menaxhimin e investimeve publike. BE-ja inkurajon Shqipërinë të ngrëjë një Këshill Fiskal me qëllim forcimin e besueshmërisë së politikave fiskale në vend.

### 3. Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore

Bashkimi Evropian (BE) thekson se kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë për gjyqësorin ka një nivel të lartë përafrimi me *acquis-në* e BE-së dhe standardet evropiane përkatëse për **funksionimin e sistemit gjyqësori**. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të avancuar më tej **reformën në drejtësi** të vitit 2016 përmes vijimit të fuqizimit të pavarësisë së magjistratëve dhe të sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë, me qëllim konsolidimin e llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet, sigurimin e qasjes dhe cilësisë së drejtësisë, si dhe garantimin e dhënies së drejtësisë në mënyrë efikase në përputhje me *acquis-në* e BE-së dhe standardet evropiane.

BE-ja vlerëson përparimin e Shqipërisë lidhur me **pavarësinë dhe paanshmërinë** e sistemit gjyqësor dhe atij të prokurorisë. BE-ja vlerëson planet e Shqipërisë për vijimin e forcimit të kapaciteteve, pavarësisë dhe efikasitetit të organeve vetëqeverisëse të gjyqësorit dhe për konsolidimin e përparimit përmes emërimeve dhe avancimit në karrierë të bazuara në merita, duke rritur kështu transparencën

e ngritjeve në detyrë, dhe duke respektuar dhe zbatuar në mënyrë rigoroze kontrole periodike të integritetit gjatë karrierës së magistratëve. Gjithashtu, BE-ja vlerëson angazhimin e Shqipërisë për të ndjekur standardet e larta të përcaktuara nga procesi i rivlerësimit kalimtar (*vetting*) dhe për të siguruar që rregullat e shpërndarjes rastësore të çështjeve të zbatohen me efektivitet në praktikë. BE-ja vlerëson pozitivisht planet e Shqipërisë për të forcuar më tej rezistencën e institucioneve të drejtësisë ndaj rasteve të ndërhyrjes së brendshme dhe të jashtme. Gjithashtu, BE-ja thekson nevojën që pushteti ekzekutiv dhe legjislativ në Shqipëri, duhet të respektojnë dhe zbatojnë plotësisht me përparësi, vendimet detyruese të Gjykatës Kushtetuese. BE-ja thekson rëndësinë që Shqipëria të sigurojë standardet më të larta të integritetit, transparencës të bazuara në merita gjatë emërimit të anëtarëve të organeve vetërregulluese dhe të organeve të tjera kyçe të gjyqësorit dhe prokurorisë.

BE-ja vlerëson se Shqipëria ka një kuadër ligjor dhe institucional që siguron normimin e fuqishëm të **llogaridhënies**. BE-ja vlerëson pozitivisht zbatimin e vazhdueshëm të mirë të procesit të rivlerësimit kalimtar (*vetting*) nga Shqipëria dhe të planit të saj për përfundimin e këtij procesi në mënyrë të rregullt brenda afateve kushtetuese dhe nën mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). BE-ja thekson nevojën që Shqipëria të vazhdojë fillimin e procedimeve penale ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për vepra penale gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar (*vetting*), si dhe rëndësinë e zbatimit të standardeve të larta të përcaktuara nga ky proces. Gjithashtu, BE-ja vlerëson planet e Shqipërisë për të siguruar që shërbimet e inspektimit dhe institucionet vetëqeverisëse, përkatësisht Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP), të arrijnë në mënyrë të vazhdueshme një historik të qëndrueshëm të llogaridhënies dhe integritetit në të gjitha nivelet e sistemit gjyqësor. Shqipëria duhet të sigurojë nivelin më të lartë të integritetit dhe meritës në emërimin e anëtarëve jo magistratë në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe në Këshillin e Lartë të Prokurorisë.

BE-ja vlerëson se Shqipëria ka një bazë të mirë sa i përket **cilësisë dhe efikasitetit** të sistemit gjyqësor. BE-ja vlerëson pozitivisht planin e Shqipërisë për të siguruar burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare që mundësojnë funksionimin e plotë, me efikasitet dhe pavarësi të gjyqësorit, dhe që garantojnë të drejtën për akses në drejtësi. BE-ja thekson pozitivisht planin e Shqipërisë për forcimin e Shkollës së Magjistraturës, përfshirë përmirësimin e provimit pranues bazuar në transparencë dhe konkurrencë të ndershme, me qëllim ofrimin e arsimit të nivelit më të lartë për kandidatet për magjistratë. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për përmirësimin e instrumenteve të TI-së në dispozicion të gjykatave, dhe fton ngritjen në kohë të Sistemit të Integruar të Menaxhimit të Rasteve (ICMIS) dhe plotësimin e vazhdueshëm të vendeve vakante ende të paplotësuara në sistemin gjyqësor, duke e konsideruar këtë si një çështje urgjente për efikasitetin e drejtësisë.

BE-ja vlerëson se kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë **kundër korrupsionit** është pjesërisht i përafuar me *acquis-në* e BE-së. BE-ja vlerëson pozitivisht disa dënime të formës së prerë mbi akuzat për korrupsion kundër zyrtarëve të nivelit të lartë. Megjithatë, BE-ja thekson se korrupsioni është i përhapur në shumë fusha të jetës publike dhe të biznesit, përfshirë të gjitha degët e qeverisjes qendrore dhe vendore dhe në institucione, dhe mbetet një fushë që paraqet shqetësim serioz. BE-ja vlerëson më tej se masat kundër korrupsionit kanë pasur ndikim të përgjithshëm të kufizuar deri më tani, veçanërisht në sektorët që rrezikohen më shumë nga korrupsioni. BE-ja vlerëson planet e Shqipërisë për ndryshimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe institucional për luftën kundër korrupsionit, me qëllim reduktimin e kompleksitetit dhe garantimin e efikasitetit të tij. BE-ja thekson se Shqipëria duhet të bëjë progres vendimtar lidhur me luftimin e pandëshkueshmërisë dhe natyrës së kudogjendur dhe të përhapur të korrupsionit, dhe vlerëson pozitivisht planet e Shqipërisë për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe bashkërendimit të institucioneve që parandalojnë korrupsionin, për konsolidimin e kapaciteteve operacionale dhe njerëzore të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK) dhe gjykatave të posaçme, si dhe për krijimin e një historiku të qëndrueshëm në luftën sistematike kundër korrupsionit, veçanërisht në nivel të lartë, përfshirë konfiskimin përfundimtar të pasurive. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për forcimin e efikasitetit të kuadrit të parandalimit të korrupsionit, përmes trajtimit sistematik dhe me efektivitet të rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit në Këshillin e Evropës (GRECO). BE-ja vlerëson rëndësinë e garantimit nga ana e Shqipërisë që ndryshimet e legjislacionit penal në të ardhmen, përfshirë amnistitë e mundshme, të jenë në përputhje me *acquis-në* e BE-së dhe standardet evropiane si dhe të jenë të dobishme për planin që vendi ka për reduktimin e vazhdueshëm të korrupsionit.

BE-ja vlerëson se kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë është pjesërisht i përafuar me *acquis-në* e BE-së dhe standardet evropiane për të **drejtat themelore** dhe thekson se duhet fuqizuar zbatimimi me qëllim garantimin e gëzimit të të drejtave themelore në praktikë, përfshirë forcimin e kapaciteteve të institucioneve të pavarura të të drejtave themelore.

BE-ja vlerëson se nevojiten përpjekje të mëtejshme për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale në Shqipëri. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për përafrimin e kuadrit ligjor për **mbrojtjen e të dhënave personale** me *acquis-në* e BE-së dhe për forcimin e kapaciteteve institucionale të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, si dhe të kontrolluesve publikë dhe privatë, me qëllim garantimin e zbatimit me efektivitet të kësaj të drejte, përfshirë masat për ndërgjegjësimin e publikut. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të hetuar me efektivitet shkeljet e të drejtave për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë ato në shkallë të gjerë.

BE-ja vlerëson se sa i përket **lirisë së shprehjes**, kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë është pjesërisht i përafuar me *acquis-në* e BE-së dhe standardet evropiane përkatëse, dhe mbetet e nevojshme të bëhen përmirësime të konsiderueshme. BE-ja vlerëson pozitivisht planin e Shqipërisë për të bërë të mundur një reformë rrënjësore të kuadrit ligjor dhe rregullator, dhe vendosjen e masave të nevojshme zbatuese me synim: forcimin e transparencës lidhur me pronësinë e medias, pluralitetin e medias dhe pavarësinë editoriale, përforcimin e transparencës së financimit të medias nga burimet private dhe shtetërore, dhe forcimin e autonomisë së rregullatorit të medias dhe të pavarësisë së transmetuesit shtetëror.

BE-ja vlerëson se atmosfera e sulmeve verbale dhe fizike, fushatave të shpifjes dhe padive strategjike kundër pjesëmarrjes publike (SLAPP) kundër gazetarëve nuk është përmirësuar dhe vijon të jetë situatë që duhet adresuar. BE-ja thekson rëndësinë e shfuqizimit të plotë nga ana e Shqipërisë së dispozitave për fyerjen dhe shpifjen dhe të përafrimit të aspekteve civile të shpifjes me standardet evropiane. BE-ja nënvizon se do të nevojitet ndjekje e kujdesshme në mënyrë që masat dhe garancitë formale të zbatohen me efektivitet dhe të përkthehen në përmirësime të prekshme të sigurisë dhe të mjedisit të punës për gazetarët. Çdo ndryshim i kuadrit ligjor duhet të jetë në përputhje me standardet dhe rekomandimet evropiane, përfshirë opinionet e Komisionit të Venecias, dhe duhet t'i nënshtrohen konsultimeve gjithëpërfshirëse me organizatat e mediave dhe të shoqërisë civile.



Sa i përket **barazisë gjinore dhe mosdiskriminimit**, fushë në të cilën Shqipëria ka arritur përafrim të pjesshëm me *acquis-në* e BE-së, BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për përafrimin e plotë të kuadrit ligjor për mosdiskriminimin me *acquis-në* e BE-së dhe sigurimin e zbatimit të tij në mënyrë efektive, duke përfshirë zbatimin nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfshirë këtu edhe grupet LGBTIQ. Gjithashtu, BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të siguruar përafrim të plotë me *acquis-në* e BE-së për barazinë gjinore, përfshirë Konventën e Stambollit, veçanërisht për luftimin në mënyrë efektive të dhunës me bazë gjinore, për rritjen e kapaciteteve institucionale përfshirë këtu organet e barazisë, dhe për forcimin e qëndrueshmërisë së strehimoreve për viktimat e dhunës. BE-ja nënvizon nevojën për të siguruar zbatimin e masave në kohë, përfshirë përafrimin e dispozitave ligjore për mosdiskriminimin, luftën kundër krimeve dhe gjuhës së urrejtjes, dhunës me bazë gjinore dhe për sigurimin e barazisë gjinore. BE-ja fton Shqipërinë të përcaktojë burime të përshtatshme për rritjen e kapaciteteve institucionale dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së shërbimeve për dëmshpërblim/kompensim dhe asistencë për viktimat. Shqipëria angazhohet të fuqizojë më tej të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të respektuar dhe forcuar mbrojtjen e të **drejtave të fëmijës** duke shtrirë më tej disponueshmërinë e shërbimeve me bazë në komunitet, me qëllim pakësimin e institucionalizimit të fëmijëve. BE-ja vlerëson rëndësinë që ka për Shqipërinë përparimi vendimtar në përfundimin e tranzicionit drejt kujdesit me bazë në komunitet, përfshirë edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara. BE-ja nënvizon nevojën e zbatimit të reformës në kohë me qëllim sigurimin e respektimit të parimit të interesit më të lartë të fëmijës.

Sa i përket të **drejtës së pronës**, BE-ja vlerëson se Shqipëria ka miratuar aktet nënligjore në zbatim të Ligjit për kadastrën dhe Ligjit për përfundimin e proceseve tranzitore të pronësisë, por në këtë fushë ka ende sfida të rëndësishme lidhur me zbatimin. Në veçanti, sipas Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës, sistemi efikas dhe transparent i regjistrimit dhe menaxhimit të integruar të pasurive, që siguron tituj të qartë dhe të sigurt pronësie në Shqipëri do të jetë në funksion, përmes një shërbimi tërësisht të digjitalizuar në praktikë, me qëllim garantimin e të drejtës së pronës brenda vitit 2030. Në këtë kontekst, Shqipëria ka përcaktuar dy qëllime të ndërmjetme për vitin 2026 dhe 2028 përkatësisht: synimi i parë ka të bëjë me digjitalizimin e hartave kadastrale, ndërsa i dyti me përfundimin e procesit të regjistrimit të parë. Në këtë kuadër, BE-ja gjithashtu thekson se Shqipëria duhet të sigurojë publikimin e hartave kadastrale krahas procesit të digjitalizimit, çka aktualisht vijon të jetë i kufizuar. BE-ja thekson se është e rëndësishme që Shqipëria të sigurojë gjithashtu se pas publikimit të hartave kadastrale individuale dhe pas dorëzimit të dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e pronës nga personi i interesuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës të procedojë, sipas përcaktimit në kuadrin e saj ligjor në fuqi, me lëshimin e certifikatës së pronësisë brenda afatit të përcaktuar prej 45 ditësh, ose të informojë palën e interesuar se prona në fjalë është e pretenduar nga palë të treta (shtet apo privat qoftë), në mënyrë që pala e interesuar të ketë mundësi t'i drejtohet gjyqësorit.

Për më tepër, BE-ja bën thirrje që Agjencia Shtetërore e Kadastrës të vërë në zbatim masa të fuqishme kundër korrupsionit përmes një Plani të Integriteti Antikorrupsion (PIA) që pasqyron reagimin e palëve të interesit me qëllim përmirësimin e transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies gjatë ofrimit të shërbimit, duke nisur nga viti 2025, siç parashikohet në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës. Ajo nënvizon gjithashtu se marrja e sqarimeve periodike dhe gjithëpërfshirëse lidhur me zbatimin e PIA-s mbetet element thelbësor. BE-ja thekson se 'Agjencia për Trajtimin e Pronave' duhet gjithashtu të funksionojë me transparencë të plotë. Ajo bën thirrje për përcaktimin e një afati të arsyeshëm për kryerjen e kompensimeve të mundshme, brenda vitit 2026, siç përcaktohet në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës. Në këtë aspekt, BE-ja i bën thirrje autoriteteve shqiptare të trajtojnë gjithashtu edhe çështjen e dokumentacionit të falsifikuar, siç përshkruhet në Përfundimet e Këshillit për Zgjerimin të dhjetorit të vitit 2023. Për më tepër, BE-ja rithekson se rishikimi i ligjeve për investimin në përputhje me praktikën më të mira të BE-së vijon të jetë çështje me përparësi tepër të lartë për tu adresuar deri në vitin 2026, siç parashikohet në Agjendën e Reformave të Planit të Rritjes. Në veçanti, ajo i bën thirrje autoriteteve shqiptare të sigurojnë që shpronësimet në kuadër të "interetit publik" të shoqërohen me kompensime të drejta të pronarëve të ligjshëm. Ajo gjithashtu thekson se procesi i qartë i klasifikimit të pronave (tokë bujqësore apo truall për ndërtim) do të ndihmonte në parandalimin

e klasifikimit të gabuar apo akteve të abuzimit. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për sigurimin e mbrojtjes së efektshme gjyqësore dhe sigurimin e zbatimit të vazhdueshëm të vendimeve të gjykatave, veçanërisht të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në këtë fushë. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e personave të pakicave, në përputhje me detyrimet e saj ndërkombëtare si dhe standardet evropiane dhe ndërkombëtare, duke siguruar ndër të tjera zbatimin e në mënyrë efektive të kuadrit ligjor. BE-ja vijon të nxisë Shqipërinë të miratojë aktet nënligjore zbatuese të mbetura lidhur me vetëidentifikimin dhe të drejta të tjera përkatëse, dhe lidhur me përdorimin e gjuhëve të pakicave kombëtare në kontaktet e tyre me organet administrative dhe autoritetet publike, deri në fund të vitit 2024, siç parashikohet në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës. BE-ja thekson se miratimi dhe zbatimi i shpejtë të këtyre akteve nënligjore në mbarë territorin duhet të jetë në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare, të ketë përfshirjen e të gjitha palëve përkatëse të interesit, të jetë në përputhje me Konkluzionet e Këshillit për Zgjerim të dhjetorit të vitit 2023. Gjatë miratimit të akteve nënligjore të lartpërmendura, BE-ja i bën thirrje autoriteteve shqiptare të sigurojnë që e drejta e vetëidentifikimit të respektohet si në ligj, ashtu edhe në praktikë, në përputhje me standardet evropiane dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, BE-ja vlerëson nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale të Komitetit Shtetëror për Pakicat Kombëtare dhe autoriteteve vendore. Sa i përket komunitetit rom dhe egjiptian, BE-ja vlerëson planet e Shqipërisë për përmbushjen e angazhimeve në kuadër të Deklaratës së Poznanit në fushën e arsimit, punësimit, strehimit dhe shëndetësisë, dhe për fuqizimin e Pikës Kombëtare të Kontaktit për Romët. BE-ja fton Shqipërinë të akordojë burime kombëtare të përshtatshme për zbatimin e masave të politikave dhe të përforcojë bashkërendimin në këtë fushë, BE-ja vlerëson më tej se Shqipëria ka dispozita në fuqi që u mundësojnë personave të pakicave të ruajnë dhe të zhvillojnë trashëgiminë e tyre kulturore dhe të nxisin njohuritë për historinë e tyre.

BE-ja nënvizon se Shqipëria duhet të sigurojë përafrim të plotë të kuadrit të saj ligjor me *acquis-në* e BE-së në momentin anëtarësimit me qëllim sigurimin e gëzimit të plotë të të **drejtave si qytetarë të BE-së**.

#### 4. Kapitulli 24 - Drejtësia, liria dhe siguria

BE-ja vlerëson se Shqipëria ka kuadrin ligjor dhe institucional në fuqi për **luftën kundër krimin të organizuar**, megjithëse ka nevojë të miratohen ndryshime të këtij kuadri për arritjen e përafrimit të plotë me *acquis-të* e BE-së, çka përfshin legjislacionin për kriminalizimin e pastrimit të parave, si dhe në lidhje me rikuperimin dhe konfiskimin e pasurisë. BE-ja nënvizon se bashkëpunimi i Shqipërisë në fushën e zbatimit të ligjit me Vendet Anëtare të BE-së, CEPOL-in, Eurojust-in dhe Eurojust-in, si dhe përfshirja shumë aktive me EMPACT-in, po sjellin rezultate pozitive. BE-ja vlerëson se këto përpjekje duhet të përforcohen më tej. Gjithashtu, BE-ja nënvizon se ka nevojë për përpjekje të mëtejshme për konsolidimin e historikut të hetimeve, ndjekjeve penale, dënimeve të formës së prerë, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive që kanë lidhje me krimin e organizuar dhe pastrimin e parave, si dhe për bashkëpunimin ndërkombëtar proaktiv dhe të efektshëm. BE-ja vlerëson se Shqipëria duhet t'u sigurojë burimet e përshtatshme institucioneve që luftojnë kundër krimin të organizuar. Gjithashtu, BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të siguruar që procedimet penale të shoqërohen sistematikisht me hetime financiare që prej fillimit të tyre, dhe për të ngritur kapacitetet për ndërmarrjen e hetimeve financiare të ndërlikuara. BE-ja vlerëson më tej angazhimin e Shqipërisë për të shtuar sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive, për të ngrirë pasuritë që lidhen me veprimtaritë kriminale dhe për të nxitur ripërdorimin social të tyre.

BE-ja vlerëson se Shqipëria është hequr nga lista e juridiksioneve nën monitorim të shtuar nga Task Forca e Veprimit Financiar (FATF) pas pezullimit të amnistisë së planifikuar fiskale dhe programit të përmbushjes tatimore vullnetare. BE-ja vlerëson rëndësinë që ka për Shqipërinë garantimi që ndryshimet e ardhshme të legjislacionit penal, përfshirë amnistitë e ndryshme dhe programet e përmbushjes tatimore vullnetare, të jenë në përputhje me planet e vendit dhe të çojnë përpara luftën kundër krimin të organizuar, dhe të jenë në përputhje me *acquis-të* e BE-së dhe standardet ndërkombëtare përkatëse, si ato të përcaktuara nga Moneyval-i dhe FATF-ja.

BE-ja e fton Shqipërinë të miratojë të gjitha ligjet e nevojshme dhe masat zbatuese në fushën e **krimit kibernetik** dhe të miratojë protokollin e dytë shtesë të Konventës së Budapestit për ta luftuar krimin kibernetik në mënyrë efektive. BE-ja konstaton se Shqipëria duhet të zhvillojë një historik të qëndrueshëm lidhur me parandalimin dhe luftën ndaj krimit kibernetik, sidomos nëpërmjet reagimit dhe rritjes më efektive të zbatimit të ligjit, që përqendrohet te zbulimi, gjurmueshmëria dhe ndjekja penale e kriminelëve kibernetikë.

BE-ja e vlerëson faktin që Shqipëria ka një plan për kriminalizimin e të gjitha formave të **abuzimit seksual të fëmijëve** dhe e fton Shqipërinë t'i kushtojë vëmendje të veçantë mbrojtjes dhe parandalimit (përfshirë parandalimin e riviktimizimit) të abuzimit seksual të fëmijëve online dhe offline.

BE-ja është në dijeni për numrin e madh të armëve të zjarrit të disponueshme në Shqipëri dhe e fton këtë të fundit të pakësojë mbajtjen e paligjshme dhe **trafikimin e armëve të zjarrit**. BE-ja thekson se Shqipëria duhet t'i përputhë veprimet e saj me objektivat e Udhërrëfyesit Rajonal për kontrollin më të mirë të armëve të vogla dhe të lehta (AVL) me Ballkanin Perëndimor. BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të shtuar përpjekjet për ndërgjegjësimin, informimin dhe edukimin mbi rreziqet dhe risqet lidhur me keqpërdorimin, mbajtjen e paligjshme dhe trafikimin e armëve të zjarrit/AVL-ve, si dhe reduktimin e tyre përmes legalizimit, dorëzimit vullnetar dhe çaktivizimit.

BE-ja konstaton se Shqipëria është vend origjine, tranziti dhe destinacioni për trafikimin e qenieve njerëzore dhe duhet të forcojë masat kundër këtij fenomeni, duke u përqendruar veçanërisht te ndikimi i tij i madh mbi gratë dhe vajzat. BE-ja nxjerr në pah planin e Shqipërisë për të përmirësuar identifikimin e hershëm dhe mbrojtjen e viktimave përmes një qasjeje të fokusuar te viktima, e cila duhet të bëhet më efektive dhe të integrohet në mënyrë më të qëndrueshme në hetime dhe ndjekje penale. BE-ja thekson se Shqipëria zhvillojë një historik të qëndrueshëm hetimesh proaktive, ndjekjeje penale dhe dënimesh të formës së prerë në këtë fushë.

BE-ja evidenton se autoritetet ligjzbatuese të Shqipërisë kanë ruajtur një nivel të mirë **bashkëpunimi në fushën e drogës** me homologët e saj në Shtetet Anëtare të BE-së. BE-ja e fton Shqipërinë të miratojë një kuadër strategjik gjithëpërfshirës në fushën e drogave. BE-ja thekson se përveç miratimit të një kuadri formal, do të jetë e rëndësishme që Shqipëria të tregojë një qasje strategjike gjithëpërfshirëse për të luftuar në mënyrë efektive dhe konsistente kultivimin,

prodhimin dhe trafikimin e lëndëve narkotike. BE-ja është në dijeni për planin e Shqipërisë për të forcuar dhe për të bërë operacional kuadrin e saj institucional, në veçanti duke krijuar Observatorin Kombëtar për Drogat dhe sistemin Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm për shkëmbimin e informacionit lidhur me lëndët e reja psikoaktive. BE-ja thekson nevojën e Shqipërisë për të zhvilluar një historik të qëndrueshëm për sekuestrimin dhe shkatërrimin e drogave dhe konfiskimin e pasurive.

BE-ja konstaton se Shqipëria ka një kuadër strategjik, ligjor dhe institucional për **luftën kundër terrorizmit**, i cili ka nevojë për ndryshime që të përafrohet plotësisht me *acquis* të BE-së. BE-ja evidenton planin e Shqipërisë për të ofruar burimet e duhura, për të rritur bashkëpunimin ndërkombëtar dhe ndërmjet agjencive, dhe për të forcuar mekanizmat e menaxhimit dhe referimit të rasteve. BE-ja vë në dukje përpjekjet e bëra në Parandalimin dhe Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (LEDH), në veçanti lidhur me konsolidimin e Qendrës së Koordinimit Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm (QKKEDH).

Duke vlerësuar përpjekjet e bëra, radikalizimi në burgje dhe shpërndarja e përmbajtjeve terroriste në internet vazhdojnë të kërkojnë një vëmendje të veçantë. BE-ja vëren se bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i informacioneve me përmbajtje sensitive me Europol-in dhe Shtetet Anëtare janë të kënaqshme. BE-ja thekson se nevojiten përpjekje të mëtejshme për të adresuar financimin e terrorizmit dhe pastrimin e parave, veçanërisht përmes përmirësimit të efikasitetit të hetimeve mbi financimin e terrorizmit.

Gjithashtu, BE-ja përmend faktin se Shqipëria është në proces të ndryshimit të kuadrit ligjor që rregullon përdorimin e Regjistrimit të Emrave të Pasagjerëve (REP) për të forcuar kapacitetin në luftën ndaj terrorizmit dhe veprave penale të rënda që kanë lidhje me trafikun ajror.

BE-ja thekson se Shqipëria angazhohet të **mbrojë infrastrukturën kritike** nëpërmjet rishikimit të kuadrit të saj ligjor për aftësinë rimëkëmbëse të subjekteve kritike, përmirësimit të kapaciteteve për zbulimin e infrastrukturës kritike dhe përcaktimit të kriterëve për menaxhimin e tyre, përfshirë analizën e riskut. Shqipëria duhet të garantojë instalimin e sigurt të rrjeteve 5G së bashku me zbatimin gjithëpërfshirës të paketës së instrumenteve të BE-së për sigurinë kibernetike 5G.

BE-ja vlerëson se Shqipëria ka parimet themelore të **bashkëpunimit gjyqësor në çështjet penale, civile dhe tregtare** të parashikuara në legjislacionin e saj, por nevojitet përafrim i mëtjshëm me *acquis* të BE-së. BE-ja përshëndet planin e Shqipërisë për të ratifikuar konventat ndërkombëtare përkatëse të mbetura në fushën e bashkëpunimit gjyqësor, konkretisht Konventa e Hagës për Marrëveshjet për Zgjedhjen e Gjykatës (2005). Po ashtu, BE-ja e fton Shqipërinë të rrisë kapacitetet e saj administrative për të përmbushur kërkesat e BE-së për bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, civile dhe tregtare.

Për sa i përket **migracionit**, BE-ja thekson se Shqipëria duhet të përditësojë Strategjinë e saj gjithëpërfshirëse Kombëtare për Migracionin dhe planin e saj të veprimit, dhe të vazhdojë të zbatojë Planin e Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor, të prezantuar nga Komisioni në dhjetor 2022. BE-ja thekson gjithashtu se Shqipëria duhet të hartojë, miratojë, zbatojë, testojë dhe financojë mjaftueshëm planin e kontingjenesc në rast të një numri të konsiderueshëm mbërritjesh të migrantëve dhe azilkërkuesve. Gjithashtu, BE-ja vlerëson planin Shqipërisë për të miratuar ndryshimet e nevojshme në fushën e migracionit të ligjshëm për ta përafruar atë me dispozitat e caktuara për bashkimin familjar, me lejen e vetme dhe me ndryshimet e fundit në kartën blu të BE-së. BE-ja e fton Shqipërinë të miratojë ndryshime në fushën e migracionit të parregullt për ta përafruar me Direktivën e Sanksioneve për Punëdhënësit<sup>1</sup>. BE-ja mirëpret rikthimin e kompetencave hetimore brenda Drejtorisë së Policisë së Kufirit dhe Migracionit. BE-ja evidenton nevojën për rritje të kapaciteteve dhe plotësimin me staf të Drejtorisë.. BE-ja e cilëson si shumë të mirë bashkëpunimin e Shqipërisë me Shtetet Anëtare dhe Frontex-in për operationet e ripranimit dhe kthimit. BE-ja e fton Shqipërinë të sigurojë kapacitete të përshtatshme pritjeje dhe të zbatojë procedurat e kthimit në përputhje me ligjin për të huajt dhe me *acquis* e BE-së.

BE-ja vlerëson bashkëpunimin me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Azilin lidhur me forcimin e sistemit kombëtar për **azilin** dhe pritjen. BE-ja vlerëson bashkëpunimin me Agjencinë e Bashkimit Evropian për Azilin për forcimin e sistemit kombëtar të azilit dhe pritjes. BE-ja e fton Shqipërinë ta zbatojë në mënyrë cilësore kuadrin ligjor aktual për azilin dhe të zhvillojë kapacitetet e nevojshme administrative shtesë, duke siguruar përafrimin e mëtjshëm me *acquis*. Po ashtu, BE-ja e fton Shqipërinë të bëjë referime sistematike për procedurën e azilit. BE-ja përshëndet planin e Shqipërisë për t'i trajtuar azilkërkuesit përmes mbështetjes dhe shërbimeve qeveritare të drejtpërdrejta.

BE-ja evidenton se çështja e numrit të madh të qytetarëve shqiptarë që paraqesin kërkesa të pabazuara për azil në Shtetet Anëtare të BE-së kërkon ende përpjekje të vazhdueshme dhe të qëndrueshme.

---

<sup>1</sup> Direktiva 2009/52/KE



BE-ja konstaton se **politika e vizave** e Shqipërisë nuk është përafruar ende me atë të BE-së. BE-ja bën thirrje se heqja e përkohshme e kërkesave për vizë nuk është në përputhje me *acquis* të BE-së. Gjithashtu thekson se Shqipëria ka përgatitur një plan për ta përafruar politikën e saj të vizave me BE-në dhe e fton Shqipërinë ta ndjekë këtë proces në kohë.

Gjithashtu, BE-ja thekson se sistemet e informacionit të Shqipërisë do të kërkojnë përshtatje teknike shtesë për t'u përputhur me Sistemin e Informacionit për Viza (VIS).

BE-ja e vlerëson bashkëpunimin e mirë dhe të vazhdueshëm operacional me Frontex-in për mbikëqyrjen e kufirit nëpërmjet Operacionit të Përbashkët të vënë në punë që prej vitit 2019, lidhur me **Kufijtë Shengen dhe kufijtë e jashtëm**. BE-ja bën thirrje se një pjesë e *acquis* të Shengenit do të zbatohet vetëm për Shqipërinë pas vendimit të Këshillit për heqjen e kontrolleve për personat në kufijtë e brendshëm, të marrë në bazë të vlerësimit të zbatueshëm Shengen për gatishmërinë e Shqipërisë, duke marrë në konsideratë raportin e Komisionit ku konfirmon se Shqipëria vazhdon të përmbushë angazhimet e ndërmarra në kuadër të negociatave për anëtarësim, të cilat kanë lidhje me *acquis* të Shengenit. BE-ja përshëndet planin e Shqipërisë për të trajtuar rotacionin e lartë të oficerëve në kufi.

Për sa i përket **falsifikimit të euros**, BE-ja vlerëson planin e Shqipërisë për të ndjekur shkëmbimet e informacionit me Komisionin Evropian, Europol-in dhe Bankën Qendrore Evropiane, sipas marrëveshjeve përkatëse të bashkëpunimit për mbrojtjen e monedhës euro nga falsifikimi.

## 5. Kriteri ekonomik

BE-ja thekson se Shqipëria është në rrugën e duhur për t'u bërë një **ekonomi tregu funksionale**. BE-ja thekson se Shqipëria po përparon lidhur me kapacitetin e saj për të përballuar presionin konkurrues dhe forcat e tregut brenda Bashkimit Evropian. BE-ja vë në dukje konsensusin e gjerë të vazhdueshëm në vend për themelet e politikës ekonomike, përfshirë rolin e kufizuar të shtetit në ekonomi dhe angazhimin politik për liberalizimin e tregut. BE-ja konstaton se pavarësisht progresit të shënuar në vitet e fundit, siguria e dobët juridike, niveli i lartë i ekonomisë informale, niveli i ulët i zhvillimit të sektorit financiar dhe vështirësitë me regjistrimin e titujve të pronësisë së tokës vazhdojnë të kufizojnë funksionimin efektiv të ekonomisë së tregut, gjë që pasqyrohet në konvergjencë dhe rritjen të ulët, nën potencial. BE-ja e fton Shqipërinë të trajtojë sistematikisht dhe plotësisht rekomandimet e BE-së për politikën, të përcaktuara në paketat e njëpasnjëshme të zgjerimit dhe udhëzimin e përbashkët të politikave në kontekstin e Konkluzioneve të Përbashkëta të Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, si dhe angazhimet e ardhshme në kuadër të Planit të Rritjes, që duhet ta ndihmojnë Shqipërinë të përmbushë kriteret ekonomike. Pavarësisht mangësive të konsiderueshme që mbeten në krahasim me nivelet rajonale dhe evropiane, BE-ja thekson se infrastruktura në fushën e energjisë dhe transportit, digjitalizimi i ekonomisë dhe rezultatet në fushën e arsimit janë përmirësuar dukshëm. BE-ja thekson se investimet në të gjitha fushat e infrastrukturës fizike duhet të vazhdojnë në nivele të larta, së bashku me përmirësimet në reformat e të menaxhimit të investimeve publike dhe qeverisjes. BE-ja e fton Shqipërinë të përmirësojë konkurrueshmërinë e saj, që aktualisht pengohet nga mungesa e njohurive sipërmarrëse dhe teknologjike, nevojat e papërmbushura për investime në zhvillimin njerëzor, si dhe nga shpenzimet vazhdimisht të ulëta për kërkimin shkencor dhe zhvillimin, përmes cilësisë së lartë dhe niveleve të larta të rezultateve të arsimit, dhe incentivave për të investuar në kërkimin shkencor. BE-ja e fton Shqipërinë të rrisë shkallën e mbulimit dhe përshtatshmërisë së politikave të mbrojtjes sociale dhe sigurimeve shëndetësore për të ulur përqindjen e popullsisë të riskuar nga varfëria, me qëllim mundësuar në zhvillimit ekonomik gjithëpërfshirës dhe të ekuilibruar në aspektin social.

## 6. Kapitulli 5 - Prokurimi publik

BE-ja vlerëson nivelin e lartë të përafritit të Shqipërisë me *acquis* të BE-së në fushën e **sektorëve klasikë dhe të shërbimeve**. BE-ja e fton Shqipërinë të rishikojë kufijtë monetarë për kontratat e furnizimeve dhe shërbimeve për të përafuar periudhat minimale që zbatohen në procedurat e prokurimit, si dhe afatet për dorëzimin e ankesave, me Direktivat e BE-së për Prokurimin Publik. BE-ja thekson se në fushën e koncesioneve, Shqipëria është pjesërisht e përafuar me *acquis* të BE-së. BE-ja e fton Shqipërinë të harmonizojë më tej për të trajtuar, ndër të tjera, çështje të tilla si, propozimet e pakërkuara, riskun operativ, dhe fushën e zbatimit të ligjit. BE-ja nxjerr në pah nevojën e Shqipërisë për t'u përafuar me *acquis* të BE-së në fushën e **prokurimit të mbrojtjes**.

BE-ja vlerëson se Shqipëria është mesatarisht e përgatitur në lidhje me **kapacitetet zbatues** të prokurimit publik. Krahas eficiencës, BE-ja thekson se sistemi i prokurimit publik duhet t'i kushtojë më shumë vëmendje transparencës, integritetit dhe konkurrencës në fushën e prokurimit. BE-ja e fton Shqipërinë të forcojë mbështetjen për autoritetet kontraktore përmes Agjencisë së Prokurimit Publik për të përmirësuar funksionimin e sistemit të prokurimeve publike.

BE-ja vlerëson nivelin e lartë të përafritit të Shqipërisë me Direktivën e **Mjeteve Juridike**. BE-ja konstaton se zbatimi nga Shqipëria i sistemit gjithëpërfshirës të menaxhimit të ankesave dhe sistemit elektronik të menaxhimit të ankesave ka arritur nivel të lartë transparence dhe ka përmirësuar përpunimin në kohë të tyre. BE-ja e fton Shqipërinë të përmirësojë kapacitetet e Komisionit të Prokurimit Publik për të trajtuar një numër më të lartë ankesash.

## 7. Kapitulli 18 - Statistikat

BE-ja evidenton se infrastruktura statistikore e Shqipërisë është pjesërisht në përputhje me *acquis* të BE-së. BE-ja e fton Shqipërinë të alokojë burime të mjaftueshme për sektorin e statistikave për të arritur përafrim të plotë me *acquis* të BE-së.

BE-ja thekson se Shqipëria e ka zbatuar klasifikimin kryesor të BE-së në shkallë të ndryshme përputhshmërie me *acquis*. BE-ja e fton Shqipërinë të ndërmarrë veprime të mëtejshme të nevojshme në lidhje me regjistrat statistikore për të garantuar përputhshmërinë e plotë me *acquis*-in e BE-së. BE-ja evidenton përafrimin e pjesshëm të Shqipërisë me *acquis* të BE-së për statistikat sektoriale. BE-ja e fton Shqipërinë të bëjë progres të mëtejshëm në të gjitha fushat statistikore për të arritur përafrim të plotë.

## 8. Kapitulli 32 - Kontrolli financiar

BE-ja evidenton se Shqipëria është pjesërisht e përafuar me *acquis* të BE-së lidhur me **kontrollin e brendshëm financiar publik** dhe që kuadri legjislativ i Shqipërisë është gjerësisht në përputhje me standardet e BE-së. BE-ja thekson se sistemi i kontrollit të brendshëm është pjesërisht efektiv dhe llogaridhënia menaxheriale mbetet e kufizuar në praktikë. BE-ja e fton Shqipërinë të përmirësojë zbatimin efektiv të kontrollit të brendshëm dhe të përforcojë monitorimin nga Njësia Qendrore e Harmonizimit.

BE-ja e fton Shqipërinë të rrisë impaktin e **funksioneve të kontrollit** të brendshëm dhe të jashtëm për t'u përafuar plotësisht me standardet dhe parimet profesionale të BE-së.

BE-ja e fton Shqipërinë të përafrojë plotësisht legjislacionin e saj kombëtar me Direktivën e BE-së në luftën kundër mashtrimit ndaj **interesave financiare të BE-së** përmes legjislacionit penal.

BE-ja e fton Shqipërinë të zyrtarizojë dhe të forcojë bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente kombëtare për **mbrojtjen e euros nga falsifikimi**.

\* \* \*

Për sa i përket gjendjes aktuale të përgatitjeve të Shqipërisë, BE-ja thekson se për të kuptuar se Shqipëria duhet të vazhdojë të bëjë progres në përafrimin dhe zbatimin e *acquis* të BE-së dhe standardeve evropiane përkatëse, të përfshira në Grupimin e I-rë, *piketat e ndërmjetme* të mëposhtme duhet të përmbushen përpara se të ndërmerren hapat e radhës në procesin e negocimit të grupimit:

- në nivelin horizontal, për Grupimin e I-rë Shqipëria siguron monitorim nga afër dhe të përhershëm të zbatimit të qëndrueshëm të Udhërrëfyesve për “Shtetin e së Drejtës”, “Reformës në Administratën Publike” dhe “Funksionimit të Institucioneve Demokratike” nëpërmjet një mekanizmi të qëndrueshëm dhe shumëdisiplinor, duke i kushtuar vëmendje të veçantë mjaftueshmërisë së burimeve njerëzore, respektimit të afateve kohore dhe dialogut aktiv me shoqërinë civile.

### **Kapitulli 23 - Gjyqësori dhe të drejtat themelore**

**Shqipëria zbaton më tej reformën gjithëpërfshirëse në drejtësi, duke bërë përmirësime në paanshmërinë, pavarësinë, llogaridhënien, profesionalizmin, cilësinë dhe eficiencën e sistemit gjyqësor. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë standard pasi të ketë:**

- Vijuar zbatimin e mirë të reformës në drejtësi e cila duhet të konsolidohet në përputhje me *acquis* të BE-së dhe standardet evropiane, nëpërmjet forcimit të mëtejshëm të kapaciteteve, efektivitetit dhe pavarësisë, përfshirë parimet e integritetit, meritës dhe transparencës së organeve vetëqeverisëse të gjyqësorit, konkretisht ë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, përfshirë emërimin e anëtarëve të tyre;
- Forcuar pavarësinë dhe llogaridhënien përmes përfundimit të rregullt të procesit të vlerësimit kalimtar (*vetting*), nën mbikëqyrjen e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, dhe vijuar llogaridhënien dhe integritetin në sistemin gjyqësor në të gjitha nivelet pas vlerësimit kalimtar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë që kanë kapacitetet e duhura, nëpërmjet vlerësimeve tërësore, verifikimit sistematik dhe efektiv të deklarimeve të pasurive në vazhdimësi me standarde të larta të përcaktuara nga vlerësimi kalimtar (*vetting*), zbatimi konsistent i emërimeve dhe ngritjeve në detyrë të bazuara në meritë, dhe sigurimi i qëndrueshmërisë sistematike të sistemit gjyqësor ndaj përpjekjeve për ndikime të panevojshme të brendshme dhe të jashtme;

- Përmirësuar cilësinë e gjyqësorit, përmes reduktimit të konsiderueshëm të çështjeve të prapambetura për trajtim duke arritur dy të tretat e parashikimeve të planifikimit vjetor, bazuar në kriteret objektive me elemente cilësore dhe sasiore, përparimit të ndjeshëm të publikimit në kohë të vendimeve të arsyetuara, përmirësimit të cilësisë së trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm, forcimit të Shkollës së Magjistraturës, sidomos duke siguruar integritetin dhe cilësinë e stafit mësimdhënës, dhe duke përmirësuar kapacitetet dhe provimin pranues;
- Përmirësuar gradualisht efikasitetin dhe performancën e gjykatave dhe prokurorive, dhe të ketë promovuar shërbime cilësore të drejtësisë, përfshirë kohën më të shkurtër të shqyrtimit, reduktim të çështjeve të prapambetura, plotësimin e më shumë se gjysmës së vendeve vakante në sistemin gjyqësor dhe rritjen e stafit mbështetës, duke siguruar investime të mjaftueshme në buxhetin e gjyqësorit për të mbuluar si duhet nevojat e gjyqësorit, përfshirë infrastrukturën, duke arritur mesataren e BE-së, nxitjen e zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve dhe ngritjen e një sistemi të integruar të menaxhimit të çështjeve që funksionon mirë.

**Shqipëria bën progres të konsiderueshëm në trajtimin dhe parandalimin e korrupsionit. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë piketë kalimtare pasi të ketë:**

- Forcuar kapacitetet operacionale dhe të ketë konsoliduar burimet financiare dhe njerëzore të organeve të specializuara kundër korrupsionit dhe të institucioneve të zakonshme gjyqësore për të luftuar korrupsionin;
- Bërë progres të prekshëm në të gjitha nivelet për një historik të qëndrueshëm hetimesh, ndjekjesh penale dhe dënimesh për çështje korrupsioni, në veçanti dënime të formës së prerë në nivele të larta, përfshirë sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive;
- Forcuar efikasitetin e kuadrit për parandalimin e korrupsionit, duke përfshirë arritjen e një progresi të konsiderueshëm në zbatimin e rekomandimeve të GRECO-s, duke siguruar verifikimin efektiv të deklarimeve të pasurive dhe mbylljen konsistente të hetimeve administrative me sanksione përkatëse dhe referimin për ndjekje penale;

**Shqipëria forcon më tej në praktikë mbrojtjen e të drejtave themelore. Në veçanti, Shqipëria do ta përmbushë këtë piketë kalimtare pasi të ketë:**

- Miratuar dhe filluar zbatimin e reformës për mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me *acquis* të BE-së, përfshirë zbatimin e përgjigjes sistematike dhe masave efektive për të mbrojtur privatësinë dhe të dhënat personale;
- Forcuar lirinë e shprehjes, përfshirë lirinë e medias, nëpërmjet një kuadri të reformuar ligjor dhe rregullator në përputhje me standardet evropiane, praktikat më të mira dhe rekomandimet e masat konkrete për të rritur sigurinë e gazetarëve;
- Forcuar kapacitetet institucionale të organeve të barazisë, të ketë siguruar përafrim ligjor me *acquis* të BE-së për mosdiskriminimin, barazinë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore, dhe të ketë siguruar mekanizma efektivë për kompensim dhe asistencë për viktimat, të siguruar në pjesën më të madhe nga buxheti i shtetit;
- Forcuar sistemin e mbrojtjes së fëmijës, ku parimi udhëheqës është interesi më i lartë i fëmijës, përfshirë atë lidhur me fëmijët e privuar nga kujdesi prindëror ose fëmijët me aftësi të kufizuara, sidomos përfundimin e tranzicionit drejt kujdesit komunitar;
- Bërë progres vendimtar për krijimin e një sistemi efikas dhe transparent të regjistrimit dhe menaxhimit të integruar të pronave, i cili siguron tituj pasurie të qartë dhe të sigurt, dhe të një shërbimi plotësisht të digjitalizuar në praktikë, të paktën lidhur me angazhimet përkatëse të Shqipërisë të ndërmarra në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës, pasi të ketë bërë progres vendimtar për të siguruar se të gjitha të dhënat kadastrale, përfshirë titujt e pronësisë dhe hartat kadastrale, digjitalizohen dhe përditësohen me kujdes për të hequr në mënyrë sistematike mbivendosi ose të dhënat e pasakta, ose se të gjitha ankesat trajtohen me efikasitet , dhe për të siguruar përfundimin e regjistrimit të parë të pasurive të paktën sipas angazhimeve përkatëse të Shqipërisë të ndërmarra në Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës, pasi të ketë reduktuar çështjet e prapambetura gjyqësore mbi pronat dhe zbatimin efektiv të vendimeve të gjykatës;

- Miratuar aktet nënligjore lidhur me vetidentifikimin falas dhe përdorimin e gjuhëve të personave që u përkasin minoriteteve, sikurse parashikohet në Udhërrëfyesin për Shtetin e së Drejtës, dhe në përputhje me standardet evropiane dhe të ketë forcuar kapacitetet zbatuese, përfshirë Komitetin për Pakicat Kombëtare dhe burimet e tij;
- Forcuar përafrimin e kuadrit ligjor me *acquis* të BE-së për të drejtat e shtetësisë.

## **Kapitulli 24 - Drejtësia, liria dhe siguria**

**Shqipëria bën progres të prekshëm në luftën kundër krimit të organizuar. Në veçanti, Shqipëria do të përmbushë këtë piketë kalimtare sapo të ketë:**

- Përafruar më tej *acquis* të BE-së për luftën kundër krimit të organizuar, përfshirë kriminalizimin e pastrimit të parave, si dhe rikuperimin dhe konfiskimin e aseteve.
- Bërë progres të prekshëm për një historik të qëndrueshëm hetimesh, ndjekjesh penale dhe dënimesh të formës së prerë në të gjitha fushat e krimeve të rënda dhe krimit të organizuar (përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore dhe abuzimin seksual të fëmijëve, krimin kibernetik, trafikimin e armëve, trafikimin e drogave), pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Dëshmuar një praktikë të besueshme dhe të qëndrueshme të nisjes së hetimeve financiare paralele që kanë të bëjnë me krimin e organizuar dhe pastrimin e parave.
- Të ketë bërë përparim të prekshëm drejt një historiku të qëndrueshëm në sekuestrimin dhe konfiskimin përfundimtar të aseteve, me një zyrë të rikuperimit të aseteve plotësisht funksionale, e cila është përgjegjëse për identifikimin dhe gjurmimin e aseteve kriminale, siç parashikohet nga legjislacioni kombëtar;
- Bërë progres të konsiderueshëm në shpërbwrijen e rrjeteve të trafikimit të qenieve njerëzore, me fokus me fokus të veçantë në ndikimin e rëndësishëm të gratë dhe vajzat..



**Shqipëria shton përpjekjet e saj për bashkëpunim në fushën e drogave. Në veçanti, Shqipëria do të përmbushë këtë piketë kalimtare sapo të ketë:**

- Krijuar Sistemin Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Observatorin Kombëtar të Drogave, funksional dhe me burime të mjaftueshme, dhe të ketë përafruar legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së për drogat dhe prekursorët e drogave;
- Bërë progres të prekshëm për një historik të qëndrueshëm të sekuestrimit dhe shkatërrimit të drogave dhe konfiskimit të pasurive përkatëse, duke garantuar zbatimin e rreptë të masave ndëshkuese kundër kultivimit të paligjshëm të kanabisit.

**Shqipëria garanton rezultate konkrete të rëndësishme në fushat e migracionit të ligjshëm dhe të parregullt, azilit, për çështjet e lidhura me *acquis* të Shengenit dhe kufijve të jashtëm, në përputhje me Planin e Veprimit të BE-së për Ballkanin Perëndimor. Në veçanti, Shqipëria do të përmbushë këtë piketë kalimtare sapo të ketë:**

- Siguruar kapacitete të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për menaxhimin e kufijve dhe staf të mjaftueshëm për të menaxhuar flukset e përziera të migracionit, përfshirë kapacitete të mjaftueshme për pranimin, mjete efikase realizimin e kthimeve, plane për menaxhimin e mbërritjeve të shtuara, në përputhje me strategjinë ekzistuese në fuqi të migracionit, si dhe të ketë rritur përafrimin me politikën e vizave në bazë të një plani konkret;
- Bërë progres të konsiderueshëm në luftën kundër kontrabandës së migrantëve;
- Siguruar ekzistencën e një procedure azili funksionale sipas *acquis* të BE-së dhe standardeve evropiane, ku shteti ofron shërbimet e nevojshme për azilkërkuesit.

\* \*

Për sa i përket gjendjes aktuale të përgatitjes së Shqipërisë dhe në kuadër të përmbushjes së piketave të ndërmjetme nga Shqipëria për Udhërrëfyesin e Shtetit të së Drejtës, BE-ja thekson se, për të kuptuar se Shqipëria duhet të vazhdojë të bëjë progres në përafrimin dhe zbatimin e *acquis* të BE-së, të përfshirë në kapitujt vijues, dhe pa cenuar kushtet shtesë të vendosura në piketat e tjera të përcaktuara në Grupimin e I-rë, ato mund të mbyllen përkohësisht sapo të jetë rënë dakord nga BE-ja për përmbushjen e piketave të mëposhtme:

### **Kapitulli 5 - Prokurimi publik**

- Shqipëria e ka përafruar plotësisht kuadrin e saj ligjor kombëtar me *acquis* të BE-së në lidhje me të gjitha fushat e prokurimit publik, përfshirë legjislacionin e saj për koncesionet dhe partneritetin

publik-privat, dhe marrëveshjet ndërkombëtare që përjashtojnë prokurime të caktuara nga rregullat e prokurimit publik, në përputhje me Traktatin e KE-së, legjislacionin e BE-së për prokurimin dhe dispozitat e tjera përkatëse të *acquis* të BE-së.

- Shqipëria ka kapacitete të mjaftueshme administrative dhe institucionale në të gjitha nivelet dhe merr masat e duhura për të siguruar zbatimin dhe ekzekutimin e duhur të legjislacionit kombëtar në këtë fushë në kohën e përshtatshme përpara anëtarësimit aderimit;
- Shqipëria demonstroi historik të qëndrueshëm të sistemit të drejtë dhe transparent të prokurimit publik, i cili garanton vlerën për paratë, konkurrencën dhe masa të forta mbrojtjeje kundër korrupsionit. Shqipëria dëshmon një historik të qëndrueshëm të një sistemi të drejtë dhe transparent të prokurimit publik, i cili garanton vlerë për paratë e shpenzuara, nxit konkurrencën dhe ofron masa të forta mbrojtëse kundër korrupsionit.

### **Kapitulli 18 - Statistikat**

- Shqipëria dorëzon të dhëna kyçe makroekonomike (llogari kombëtare dhe GFS/EDP) në përputhje me metodologjinë e Sistemit Evropian të Llogarive Kombëtare dhe Rajonale (ESA) 2010, si dhe programin e transmetimit ESA 2010, kërkesat për njoftim EDP dhe kërkesa të tjera, së bashku me përshkrimin e detajuar të kërkuar për metodologjinë e përdorur, dhe Eurostat-i do të ketë verifikuar tashmë të dhënat dhe përshkrimet e paraqitura dhe do të ketë konfirmuar tashmë përafrimin e duhur me rregullat e BE-së lidhur me afatet kohore, për plotësimin, koherencën, transparencën dhe saktësinë;
- Shqipëria miraton një udhërrëfyes për: (i) mbylljen e boshllëqeve të mbetura në të gjitha tabelat ESA 2010, (ii) transmetimin e tabelave të mbetura nga Programi i Transmetimit ESA 2010, (iii) mbylljen e boshllëqeve të mbetura në informacionet që do të ofrohen, së bashku me tabelat EDP, dhe (iv) zbatimin e çështjeve të mbetura metodologjike. Eurostat-i konfirmon përshtatshmërinë e udhërrëfyesit.

## **Kapitulli 32 - Kontrolli financiar**

- Shqipëria ka kapacitete të mjaftueshme administrative dhe institucionale në të gjitha nivelet dhe merr masat e duhura për të siguruar zbatimin dhe efektshmërinë e legjislacionit kombëtar për kontrollin e brendshëm financiar publik;
- Kontrolli i Lartë i Shtetit (KLSH) vepron në përputhje me standardet e Organizatës Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditit (INTOSAI);
- Shqipëria siguron bazë ligjore gjithëpërfshirëse për të ruajtur konfidencialitetin e hetimit të OLAF dhe kapacitete të mjaftueshme operacionale për shërbimin e saj kombëtar të koordinimit kundër mashtrimit. Shqipëria zbaton në mënyrë efikase Strategjinë Kombëtare kundër Mashtrimit për mbrojtjen e interesave financiarë të BE-së. Shqipëria zbaton koordinimin efektiv të aktiviteteve kundër mashtrimit dhe ka një historik të qëndrueshëm për bashkëpunimin me Komisionin, OLAF-in dhe Zyrën Evropiane të Prokurorit Publik (EPPO) lidhur me parregullsitë e raportuara dhe çështjet e hetimit që përfshijnë fonde të BE-së për të përmbushur detyrën e tyre plotësisht;
- Shqipëria zbaton Konventën Ndërkombëtare të Gjenevës 1929 për ndalimin e shtypjes dhe falsifikimit të monedhave, përfron legjislacionin e saj me *acquis* të BE-së për verifikimin e autenticitetit të monedhave euro dhe trajtimin e monedhave euro të papërshtatshme për qarkullim dhe për verifikimin e autenticitetit të kartëmonedhave euro.

\* \*

Monitorimi i progresit në përafrimin dhe zbatimin e *acquis* së BE-së dhe standardeve evropiane përkatëse do të vazhdojë gjatë gjithë negociatave. BE-ja thekson se do t'i kushtojë vëmendje të veçantë monitorimit të të gjitha çështjeve specifike të përmendura më sipër me qëllim sigurimin e kapaciteteve administrative të Shqipërisë, kapaciteteve të saj për të përfunduar përafrimin ligjor në të gjithë sektorët e këtij grupimi, si dhe progresit të mëtejshëm në zbatim dhe forcimin e tij. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet edhe lidhjeve ndërmjet këtij grupimi dhe grupkapitujve të tjerë të negociatave. Një vlerësim përfundimtar i përputhshmërisë së legjislacionit të Shqipërisë me *acquis* të BE-së dhe standardeve përkatëse evropiane, si dhe i kapacitetit të tij zbatues mund të bëhet vetëm në një fazë të mëvonshme të negociatave. Krahas të gjitha informacioneve që BE-ja mund të kërkojë për negociatat në këtë grupim dhe që do ti sigurohen në Konferencë, BE-ja e fton Shqipërinë të raportojë rregullisht informacione të detajuara me shkrim në Këshillin e Stabilizim-Asocimit lidhur me progresin në zbatimin e *acquis* të BE-së.

Duke marrë parasysh të gjitha konsideratat e mësipërme, Konferenca do të duhet t'i rikthehet këtij grupimi në një moment të përshtatshëm.

Gjithashtu, BE-ja risjell në vëmendje se mund të ketë *acquis* të ri të BE-së midis periudhës 2 tetor 2024 dhe përmbylljes së negociatave.